

Raport Arkitektonik

**OBJEKTI: SHERBIME PROJEKTIMI PER RIGJENERIMIN URBAN TE
SHETITORES BREGDETARE QENDRORE TE VLORES, SHESHIT TE
FLAMURIT DHE PORTIT**

Qershor 2020

Hyrje

Qyteti i Vlorës po ndryshon me shpejtësi. Zona qendrore ujore rreth dhe prapa portit dëshmon për këtë. Përreth kësaj zone, gjërat po evoluojnë shpejt, projekti i Bulevardit dhe projekti i rikonfigurimit të Portit janë duke vazhduar, Promenada e Vlorës (faza 1) është implementuar dhe është planifikuar Marina e Vlorës. Në të njëjtën kohë, Sheshi Isa Boletini - punimet e para të vërteta publike në pjesën e bregdetit në vitet e fundit - është në qendër të gjithë kësaj dhe po vjetërohet dhe shkeputet pa shpresë nga pjesa tjetër e qytetit. Shetitorja e Vlorës (Faza 1) ka hedhur në lëvizje një ringjallje shumë të nevojshme për vijën ujore të Vlorës, e shoqëruar më tej nga projektet që lidhin qendrën me Ujëmbledhësin (Transbalkanica dhe Bulevardi).

Një model për një fazë të dytë të shëtitorës ekziston dhe mund të përpunohet me lehtësi. Sidoqoftë, në qendër të kilometrit të 7 të bregdetit shtrohet sfida për Promenaden, pjesën frontale ujore dhe qytetin. Si të krijohet një përvojë e vazhdueshme ujore përreth ose mbi zonën e portit të siguar? Si të zhvillohet një lagje tërheqëse në këtë zonë kaotike dhe të rimarrë lidhjen midis Vlorës dhe Mesdheut? Si t'i jepet një identitet i fortë një zone që duket se është e përbërë nga kaq shumë pjesë të vogla (Sheshi Isa Boletini, Monumenti i Pavarësisë, bazat e Universitetit, etj)? Projekti që gërsheton projektet kryesore përreth zonës dhe që krijon një identitet të fortë, të fuqishëm, ndërsa gjetja përsëri e hapësirës për trashëgimi dhe histori, mund të krijojë një pikë qendrore të qytetit të Vlorës në vijën ujore. Zona historike e Vlorës është rikualifikuar; ka vazhduar rinovime dhe rikualifikim të zonës së Kullës së Sahatit dhe ndërtesës së Komunës.

Zona e marrë në studim do të përshkruhet nepermjet ndarjes me sheshe. Sheshet do të jenë perkatesisht sheshi Isa Boletini, Sheshi Pavaresia, Sheshi i Plazës trekendore, Sheshi i zonës së Portit dhe zona e zhvillimeve në krah të sheshit Isa Boletini.

ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE

Kjo pjesë e raportit do të shprehe gjendjen e situatës ekzistuese të zonës së projektimit duke analizuar elementet me të rëndësishme përberëse të saj në të cilat mund të përfshijme

1. Muzeu i Pavaresisë
2. Sheshi Isa Boletini
3. Zhvillimet përgjatë sheshit Isa Boletini
4. Porti
5. Sheshi Pavaresia

Muzeu i Pavarësisë

Është krijuar në vitin 1936 dhe është muzeu i parë shqiptar. Prej krijimit e deri në ditët tona, është rritur, plotësuar e konsoliduar si një nga objektet më të rëndësishme muzeale jo vetëm në rrethin e Vlorës, por edhe më gjerë.

Me rastin e 50 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, u shpall Muze Kombëtar. Vetë godina dhe gjithcka ndodhet e ekspozuar në të, përfaqësojnë një nga momentet më të rëndësishme në historinë e kombit shqiptar. Në këtë godinë, janë hedhur themelet e shtetit shqiptar.

Për 6 muaj, aty u vendos dhe funksionoi Qeveria e Ismail Qemalit, që u krijua pas shpalljes së pavarësisë. Muzeu i Pavarësisë Kombëtare, konsiderohet si një objekt muzeal i pëlqyeshëm. Ai përbëhet nga 2 dhoma dhe 2 korridorë.

Në të janë ekspozuar objekte origjinale të kohës që pasqyrojnë, dokumente të rëndësishme të periudhës së Rilindjes e të Pavarësisë, si dhe vepra të ndryshme arti kushtuar kësaj periudhe, pesha e së cilës i kalon caqet lokale.

Për herë të parë pas shumë dekadash, godina e Muzeut të Pavarësisë u rehabilitua plotësisht në vitin 2002, me rastin e 90 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare.



Me këtë investim, ky objekt mori vlera të tjera dhe u bë më i pëlqyeshëm për vizitorët. Mjediset e tij i vizitojnë cdo ditë, dhjetra qytetarë. Buste të ministrave të qeverisë së parë janë vendosur në oborr bashkë me karrocën e riprodhuar sipas modelit origjinal të babait të Pavarësisë. Dorëshkrime që rrëfejnë vështirësitë në të cilat u shpall Pavarësia e vendit,

sende të ministrave, një pjesë e mobilimit të zyrës së kryeministrit Ismail Qemali, karrikja, raftet e vogla të librave, flamuj origjinalë të betejave që shoqëruan shpalljen e aktit, dokumenti i fimirëtarëve, foto që kanë fiksuar kontekstin e ngjarjeve të asaj kohe dhe tablo ku në mënyrë idilike janë portretizuar njerëzit që lanë gjurmë në ato momente. Shtëpia ndodhet në afërsi të Portit të Vlorës dhe është lehtësisht e arritshme nga distanca të shkurtra, në qytetin më të madh bregdetar të Shqipërisë

Pjesë e rëndësishme e këtij muzeu janë edhe statujat që gjenden në pjesën e jashtme të këtij objekti. Është pjesë e rëndësishme e designit pasi këto statuja do të rivendosen dhe të jenë pjesë e projektit të ri.

Sheshi Isa Boletini

Sheshi Isa Boletini është një pike e rëndësishme e qytetit jo vetëm për banorët e Vlores por edhe për vizitorët dhe turistët. Kjo pike strategjike e pozicionuar anës detit dhe e lidhur ngushtesisht me Projektin e Lungomares, Rrugën Transballkanike dhe Bulevardin Ismail Qemali në ditët e sotme shfaqet disi kaotike, me një tipologji ndrysheshme si godina banimi, hoteli, restorante e bare të cilat e kanë lënë jashtë vëmendjes Muzeun e Pavaresisë. Nëse do të na duhej ta përshkruanim këtë shesh me pak fjale do të mund të thoshim që përbehet nga një shetitore lineare e cila të çon drejt detit dhe rrethohet nga objektet e mesiperme.



Ne fillimin e shetitores hyrjen e perfaqeson figura prej te ciles ka marr emrin vete sheshi , statuja e Isa Boletinit . Element i rendesishem i ketij sheshi eshte edhe gjelberimi , i cili eshte i perbere nga fragmente te mbjella me bime te ndryshme si palma , bime shumevjecare dhe shkurre pergjate shetitores.Rekreacioni shprehet edhe nepermjet hapësirave te shatervaneve.Ne pjesen e mobilimit urban do te mund te permendnim stolat te cilet e shoqerojne shetitoren pergjate gjithe linearitetit te saj , koshave te mbeturinave te cilat jane te se njejtes trajte me shetitoren e Lungomares. Menyra e shtrimit nuk eshte totalisht e unifikuar , bizneset private perreth kesaj zone kane bere adaptimet e tyre. Eshte e nevojshme nje rikualifikim i zones , duke bere te mundur qe kjo zone ti vije me teper ne funksion qytetit.



Zhvillimet pergjate sheshit Isa Boletini

Ne kufizimin anesor te sheshit Isa Boletini sic permendem dhe me siper ndodhen biznese te cilat jane me funksion bar – restorante (pervec Muzeut te Pavaresise midis tyre).Keto biznese okupojne nepermjet mobilimeve perkatese nje pjese te konsiderueshme te hapësirës se sheshit Isa Boletini. Hapësira anesore e kalimit eshte e zene me ndenjese , tavolina dhe cadra te cilat jane ne funksion te ketyre zhvillimeve. Mungon uniformiteti i ketyre objekteve , gje qe sjell paraqitjen e crregullt te sheshit dhe i jep nje trajte private kesaj pjese te projektit. Vete Muzeu i Pavaresise e humbet vemendjen qe meriton duke qene i mbuluar nga te dyja anet prej ketyre objekteve.



Porti



Porti i Vlorës është i dyti më i madh në vend. Vlorë përfshin një port të ngarkesave të thata, portin e naftës Vlorë 1 dhe një port peshkimi. Porti konsiderohet si pjesë e Master Planit të Lungomares në Vlorë. Pjesë e këtij projekti është ndërtimi i një porti jahtesh, ndërsa Rrugës së Re Trans-Ballkanike ose Korridorit Kulturor, e cila ka përfunduar, do t'i shtohet një segment i dytë që fillon nga rruga ekzistuese për në port. Në pjesën e portit e cila do të rikonvertohet duket se shtrimi është i bërë me beton dhe me gura të crregullt të bardha dhe me tonalitete të ngjyrës bezh. Pjesa fundore e portit shërben si kufizim dhe tregon mbylljen e shetitores duke mos e bërë të mundur daljen e menjehershme në det.



Sheshi Pavaresia



Rrethrotullimi i cili ben mbylljen e njeres pjese te studimit ose i quajtur ndryshe Sheshi pavaresia rrethohet nga rruget : Rruga Kosova , Rruga Pelivan Leskaj si dhe eshte pike kyce e Bulevardit Ismail Qemali.

Pozicioni strategjik i ketij rrethrotullimi i ka trajten e nje sheshi te gjelberuar te mbjelle me bar ,bime te uleta dhe palma eshte i rrethuar nga objekte tregtare dhe rezidenca banimi te larta dhe perben nje pike reference per rruget me te rendesishme te qytetit te Vlores. Ai ka nje trajte rrethore , me nje kuote me te larte se rruget dhe esht i rrethuar nga nje bordure betoni.

Sheshi Pavaresia duke patur nje perdorim me teper ne trajten e rrethqarkullimit ka nje fluks te konsiderueshem levizjeje makinash dhe kembesoresh. Fluksi me i madh i ketyre levizjeje vjen nga

Rruga Pavaresia dhe merr kthesen ne rrugen “Kosova”. Eshte disi e veshtire te percaktohet se sa akse ka ne pjesen e ketij rrethrotullimi pasi sic shfaqet dhe neper foto numri I makinave qe kalojne ne te eshte I paqarte. Ky rrethrotullimi eshte pike reference dhe teper I rendesishem per banoret dhe vizitoret e vlores pasi ben te mundur lidhjen me rrugen Transballkanike, eshte pika kryesore shkarkuese e gjithë fluksit qe vjen nga Bulevardi si dhe mundeson daljen ne rivieren e Vlores .Duke patur parasysh qe Vlora eshte nje qytet kryesisht turistik , vizitoret ne pjesen me te madhe te rasteve do te preferojne te marrin rrugen qe kalon nga bregdeti dhe jo rrugen e vjeter.

Ne sheshin “ Pavaresia “ tipologjia mbizoteruese e objekteve qe e rrethojne perfaqesohet nga objekte banime te cilat kane katet perdhe me sherbime dhe funksione tregtare (shembull Qendra tregtare Riviera) dhe objekte hotelerie (Hotel Partner , Hotel Salvadore) .Tipologji tjeter e zones eshte edhe Pallati I Sportit Flamurtari dhe Universiteti I Vlores “Ismail Qemali “.




KONCEPTI

Projekti synon krijimin e një parku tërheqës qendror të karakterizuar nga një sekuencë hapësirash publike (jeshile dhe minerale) që kujdesen për nevojat e ndryshme të një qyteti në zhvillim si Vlora.

Parku është konceptuar si një vater e gjelbër, derdhëse midis Qytetit dhe Detit që merr parasysh transformimet e ardhshme urbane dhe infrastrukturore për të krijuar lidhje të reja fizike dhe vizuale midis të dyve.

Zona e projektit në studim ka një pozicion strategjik përse i përket rrugëve lidhëse që ka përreth. Këtu mund të përmendim afërsinë që ka me Bulevardin Ismail Qemali, Lungomaren si dhe Rrugën Transballkanike, ku të gjitha janë rrugë të cilat kanë një fluks shumë të madh si për qytetarët e Vlores për të arritur në destinacione të ndryshme të rëndësishme të qytetit, si dhe për vizitorët apo kalimtarët. Duke pasqyruar parasysh këtë është e rëndësishme të bëhet sa më e thjeshtë lidhja e kësaj zone me këto rrugë duke theksuar këtë pjesë të bregdetit.



Skeme e lidhjeve kryesore



Aksesi

Ne gjendjen ekzistuese vija bregdetare e zones se studimit dhe projektit eshte e pa aksesueshme per qytetaret dhe turistet e Vlores. Porti i Vlores e pengon kete aksesim te drejtperdrejt duke qene se siperfaqja e cila e ben kete lidhje eshte ne pronesi te tij.

Ky projekt propozon hapje e kesaj hapesire ne aspektin fizik edhe kthimi i saj ne nje zone te aksesueshme per qytetin duke bere te mundur zhvillimin e saj dhe aksesimin e saj prej qytetareve dhe turistave te Vlores.

Hapja e parkut dhe bashkimi i tij me qytetin dhe qytetaret krijone mendesine qe plazhi do te jete i aksesueshem dhe pjese e vijes bregdetare te Vlores. Duke patur parasysh nivelin e

ndryshem qe ka parku me detin, krijohet nevoja per te bere nje materializime me te mire te kesaj lidhjeje me ane te shkalleve. Keto struktura do te kene edhe dobine e shtuar per te vepruar si valethyes ne raste te stuhive. Efikasiteti i tyre eshte i provuar ne rrethana te ngjashme edhe ne vende te ndryshme si brenda territorit te Republikes se Shqiperise po ashtu edhe ne vende te ndryshme Europiane dhe ne konsiderohen si elemente perforcuese te vijes bregdetare.




Qarkullimi

Parku i propozuar do te kete disa elemente qe jane ekzistuese dhe qe ne do mund te nderhyet per ti pershtatur edhe me shume me konceptin dhe iden e projektit.

Nje element shume i rendesishem ne kete projekt eshte edhe rruga Cameria e cila ne kryqezimin e Sheshit te Pavarsise lidhet me Bulevardin Ismail Qemali, rrugen Transballkanike dhe rrugen Pelivan Leskaj. Rruga e re e propozuar do te qendroje ne tabanin e rruges ekzistuese dhe ne te do te nderhyet qe te behet me e peshtatshme si nje rruge e cila do te kaloj permes nje parku publik. Siperfaqja totale e rruges qe pershkon projektin eshte 3950m².

Nje element tjeter i rendesishem i projektit eshte edhe moli i cili ndodhet ne pjesen me jugore te zones se projektit. Moli eshte nje element me i forte lidhes midis detit dhe qytetit duke bere te mundur aksesimin e qytetareve ne te. Moli ka nje siperfaqe prej 3375m²

Qarkullimi si element ne kete propozim do te perforcohet dhe do te permirsohet edhe me shume. Duke moderuar qarkullimin ne rrugen kryesore qe kalon ne park rrugen Cameria do te krijohen mundesi per te vendosur edhe korsit e bicikletave qe do te bejne nje lidhje midis Shetitores Bregdetare te Vlores dhe Bulevardit Ismail Qemali qe tani e kane nje qarkullim te till te rregulluar. Gjithashtu qarkullimi i brendeshem do te percaktohet edhe nga vendosja e rratheve te programit qe do krijojne vetvetiu nje qarkullim organik dhe jo te sforcuar.




Programi


Me hapësirën e re të krijuar në sheshin Isa Boletini një ndër parimet kryesore të konceptit është dhe definimi i hapësirave për ata që do të kryejnë. Duke bërë të mundur ndarjen për kalim dhe atë për aktivitete bëhet dhe përcaktimi i hapësirave të gjelberta dhe hapësirave minerale publike. Hapësira e gjelbre mund të marrë funksione të ndryshme dhe mund të jetë pjesë e peizazhit. Kjo mund të kryhet nëpërmjet përcaktimit të programit në një zonim funksional që përbehet nga forma të ndryshme dhe linja të përcaktuara në zone të cilat do të mbartin lloje të ndryshme bimesish. Kjo hapësirë e gjelbre mund të integrohet fare mirë me aktivitete të tjera të cilat mund të jenë parqe lojrash për fëmijë, hapësira për skateboard, labirinte, hapësira për amfiteatar, basene ujore, tapete të gjelbra me bime shumëvjeçare, hapësira me pemë të larta, hapësira me pemë frutore, hapësira të mbjella me bime medicinale, hapësira pushimi etj, ku të gjitha

Duke përfshirë të gjitha këto aktivitete, vetë qyteti krijon një tendencë për të shpërndarë për qytetarit që ta vizitojnë dhe bëjnë të mundur orientimin e qytetit drejt kësaj hapësire bregdetare.

Një mënyrë tjetër përcaktimi i kësaj ndarjeje funksionale në shesh mund të bëhet e mundur nëpërmjet trajtimit me materiale të ndryshme.




Ground Covering	Rifiniturat e Sheshit	Symbol
Concrete Path with white Pebble Stone	Beton me gure te bardhe	M0
Dolomit	Dolomit	M1
Thin Aluminium Kerb	Profil Alumini	M2
Standart Concrete Paving Tiles 10x10x20 cm	Pllaka standerte betoni me madhesi 10x10x20cm	M3
Polished Concrete	Beton l rashinuar	M4
Pigmented Pink Concrete	Beton l pigmentuar ngjyre roze	M5
Pigmented sand Color Concrete	Beton l pigmentuar ngjyre rere	M6
Pigmented Green Concrete	Beton l pigmentuar ngjyre jeshile	M7
Crashed Basakt Gravel (dark)	Bazalt l thyer per zhavor (l erret)	M8
Red colored asphalt	Asfalt ngjyre roze	M9
Large format local Stone Tiles 2 different kinds: one for 'Mist' one for 'Water Walls'	Pllaka guri lokal te formateve te medha 2 lloje te ndryshme : nje per 'Mist' dhe nje per 'Water Walls'	M10
Rock	Gure te permasave natyrore	M11
Grey concrete- natural smooth cast	Beton gri- me siperfaqe natyrale	M12
Smooth Rounded Pebbles (white)	Gure l rrumbullaket l bardhe	M13
EPDM sportsfloor	EPDM per dyshemet sportive	M14
Concrete supportet wall structure	Mure suportues prej betoni	M15
Standart Asphalt	Asfalt standart	M16
Pigmented concrete borderstone	Bordure betoni e pigmentuar	M17
		G
Grass	Bar	G1
Sand	Rere	G2
		E
Lighting Pots	Ndricuesa	E1
Trash Bin	Kosha mbeturinash	E2
Movable Furnitures	Mobilje te levizshme	E3
Sand colored concrete with textile print in framwork	Beton me ngjyre rere me armatura te teksturuara	E4
Sand colored and polished concrete bench	Beton ngjyre rere l rashinuar per stolat	E5
Natural Stone	Gure natyral	E6
Urban furnitures Slides in inox	Rreshkitese inoksi	E7
Pre fabricated concrete wall element (light color) - Claustra	Elemente prej betoni l parafabrikuar per murin me ngjyre te hapur - Klaustra	E8
Stone rocks fit as furnitures	Gure natyrore per ulese	E9
Fence for the basket core	Rrjete per fushen e basketbollit	E10
Pergola structure: pre fab concrete columns + galvanized metal beam	Struktura e pergolas: kollona prej betoni te parafabrikuara me trare metalik te galvanizuar	E11
Rock	Gure te permasave te medha	E12
Inox Bicycle rack	Parkim bicikletash prej inoksi	E13
Playground element in wood	Elemente prej druri per kendin e femijeve	E14
	Elemente prej betoni te pigmentuar per kendin e femijeve	E15
Playground element in colored concrete		E16
Playground element in metal	Elemente metalike per kendin e femijeve	E17
Trampoline (woven polypropylene, steel springs, safete mat)	Trampoline	E18
Basket	Koshat e basketbollit	E19
Local stone cylinder pedestral	Cilinger me gure lokal per bustin	E19




PROJEKTI


Hapesira intersticiais




Duke qene se vete idea e projektit eshte ne trajten e nje parku te madh te perbere nga rrath te medhenj te cilet do te kene aktivitete dhe programe te ndryshme nga njeri tjetri nje pjese e rendesishme qe perben vete projektin eshte hapesia ndermjetese qe ngelet midis ketyre rratheve. Hapesira intersticiais apo ndermjetese ben te mundur qarkullimin e vizitoreve te parkut neper pjese te ndryshme te tij. Si e tille eshte e nevojshme qe kjo pjese e projektit te jete sa me komforte per te ecur dhe ti qendroje besnike tipologjise se parkut dhe afersise me detin. Per kete arsye materiali qe e perben kete pjese eshte dolomiti , i cili shfaqet si nje shtrese rere kompakte , me e ngjeshur dhe qe fortesohet me kalimin e kohes. Ky material gjen reference neper shembuj te ndryshem parqesh neper bote dhe ben te mundur ndjesine e reres duke i afruar vizitorët me shume me detin dhe duke krijuar nje atmosfere bregdetare.



Dolomiti është një material i durueshëm, tepër rezistent dhe shumë i përshtatshëm për hapësira të tilla dhe gjen një përdorim të gjërë nëpër parqe dhe nëpër rrugë kalimi, trotuare etj.



Në shembullin e mësipërm mund të kuptohet lidhja e dolomitit me fragmente të pjesës tjetër përbërëse të programit të cilat do të shtjellohen më poshtë. Siç hihet në fragmentin e sipër dolomiti përshtatet mjaft mirë me hapësirat e gjelbëruara dhe me bordurat e përcaktuara për to, duke u bërë kështu një hapësirë e integruar në projekt duke u ndërlidhur me materialet e tjera të cilat në të njëjtën mënyrë i përgjigjen tipologjisë së parkut bregdetar.



update?



Ne foton reference te mesiperme shprehet menyra e nderlidhjes se hapësirave te shtruar me dolomit ne parqe dhe pershtatja e ketij materiali me elementet e tjere urban dhe me gjelberimin.


Hapësira intersticiale ze nje sipërfaqe prej 20878 m².

Galeria


Sic tregohet dhe ne gjendjen ekzistuese zona e projektit ndodhet ne kufi me hapësiren e portit. Per te krijuat nje lloj ndarjeje e cila do te mundesoje kalimin ne anen tjetër te portit por qe krijon nje kufi thjesht viziv eshte menduar projektimi i nje galerie. Kjo galeri e ka piken e nisjes ne hyrjen e parkut te Shetitores se Vlores dhe do te perfundoje me kufirin tjetër ne skajin detar. Kjo galeri do te jete ne trajten e nje korridorit me strukture te perbere prej kolonash te mbuluara nga gjelberimi.

Kjo strukture do te jete me beton.

Galeria ne vetvete pershkon nje itinerar linear teper interesant duke bere nje prezantim te programeve kryesore te rratheve qe perbejne parkun , duke marr nje rrugetim qe kalon edhe neper hapësiren e Shtepise se Pavaresise. Transparenca e ketij elementi , duke lejuar mosmbylljen e hapave te kolonave por duke qene nje skelet i zhveshur ben te mundur nderthurjen e vete galerise me te gjithë pjesët e tjera te projektit .





Sic shihet dhe ne plan galeria pershkron te gjithë projektin duke krijuar nje aks linear me nje gjatesi prej 370 m dhe nje siperfaqe prej 1944m².



Sheshi i zhytyr


Ne tekstin ku pershkruhet koncepti, pike teper e rendesishme e Parkut te shetitores se Vlores eshte afrimi i qytetareve , i vete njeriut me detin. Per ta bere te mundur kete eshte menduar krijimi i nje sheshi i cili ka aksesin me te afert me detin. Qellimi i kesaj hapesire nuk eshte vetem sjellja me prane e detit por edhe krijimi i nje hapesire e cila te mund te perdoret si nje amfiteater , si nje hapesire ku mund te krijohen evente te ndryshme.





Sic shihet ne imazhin e mesiper sheshi i zhytur do te jete ne formen e nje platforme e cila eshte ne nivelin e detit dhe e lejon kalimin dhe daljen e tij ne kete shesh nepermjet carjeve te rrumbullakta te cilat duken si dritare me pamje nga vete deti.

Hapesira e perbere nga gurat natyror krijon me teper pamjen e nje bregu sic eshte i gjithe bregdeti i Vlores , me gure te medhenje te crregullt. Shkallarja ben te mundur zbritjen ne kete platforme te perbere prej betoni .



Kjo hapësirë është e pagjelberuar dhe e shtuar me beton .Duke qendruar ne shkallaren e cila te drejton drejt ketij sheshi eshte e mundur te organizohen evente te ndryshme , duke eshenderruar sheshin ne nje skene te vogel ,ose ne nje kinema verore duke i perdorur muret rrethuese si hapësira projektimi filmash.Siperfaqja eshte 102m2.



Rrathet


Pjesa qe ngelet ne projekt , duke mos konsideruar elementet e siperpermendur jane rrathet e dimensioneve te ndryshme qe perbejne programin e parkut te shetitores se bregdetit te Vlores. Programi i menduar per kete projekt eshte i ndryshem dhe okupon hapësira te larmishme. Vete programi ka 37 rrathe ku mund te permendim : rrethi i Sheshit Pavaresia , rrethi i Muzeut te Pavaresise , rreth per kend lojrash , rreth per skate park , rreth per kopsht botanik etj.

Nder me kryesoret do te mund te listojme :


Rrethi i Palmave

Ky rreth kerkon te krijojte nje atmosfere qe vizualisht te japi idene e nje oborri tropikal me palma te egra, te jete si pyll. Ky rreth do te jete ne te njejtin rrethrrrotullim qe njihet si sheshi Pavaresia. Kjo hapësire do te jete e aksesueshme ne varesi te shkurreve qe do te mbillen. Llojet e pemeve qe do te mbillen ne kete hapësire do te jene specie te ndryshme te palmave , duke perdorur ketu edhe palmat ekzistuese te cilat do te zhvendosen nga vendi aktual ne te cilen jane mbjelle dhe do te rimbillen.

Pjesa rreth e rrotull ne te cilen do te mbillen keto palma do te jete me mbulese vegjetale ose bar dhe do te jete e rrethuar me bordure. Nuk do te permbaje mobilim urban dhe do te ndricohet nga ndricuesat e rruges.



Ne kete rreth tjeter nje element tjeter edhe bordura qe do te jete perreth gjelberimit e cila sherben per ta ndare kete hapësire nga rruga e automjeteve.




Stacioni i autobuzit


Ne mungese te nje stacioni autobuzesh afer parkut te Shetitores bregdetare te Vlores eshte menduar nje stacion autobuzesh i integruar me gjelberim.Kjo do te jete nje hapësire publike qe do te sherbeje per kembesoret, makinat , bicikletat .

Do te jete i aksesueshem per te gjithë duke perfshire ketu dhe njerezit me aftesite e kufizuara.Pjesa qendrore e ketij rrethi do te jete me gjelberim .

Edhe ne pjeset e tjera te ketij rrethi do te mbillen palma te cilat do te krijojne dhe hijezim. Palmat te cilat jane ekzsituase do te ruhen ne rastet kur jane ne gjendje te mire shendetesore.



Trreni do te jete me i ngritur ne pjeset e pritjes se personave qe do te marrin autobuzin dhe shtrati i rruges eshte ne nje nivel me te ulet. Pjesa me e larte rreth e rrotull do te kete dhe hapesire per parkimin e bicikletave.





Oborri i heshtur

Nje tjetër program i rendesishem dhe qe okupon nje hapësirë të konsiderueshme ne projekt është edhe oborri i heshtur.

Atmosfera qe krijohet ne kete zone është nje element me topografi të kombinuar , ne trajte rrethore me nje perimeter të ngritur të gjelberuar dhe nje hapësirë kalimi të përbere prej shkallësh Kjo zone është e aksesueshme dhe ne të mund të ecet.


Lloji i gjelberimit qe do të jete ne kete rreth do të jete nje grup koherent me pme të cila do të jene me lartësi mesatare dhe të larta por do të lene nje hapësirë qendrore bosh.





Kendi i lodrave

Vizitoret e parkut do te jene dhe femijet dhe per kete eshte menduar dhe nje hapesire e dedikuar per ta.




Kjo hapësirë po prapë e menduar si një prej rrateve të projektit do të jetë e përbërë prej elementeve si rreshkitese , lisharese dhe lojërave të ndryshme për fëmijë të përbërë nga druri dhe betoni .Atmosfera e kësaj hapësirë do të krijohet nëpërmjet strukturave të thjeshta dhe vizualisht të këndshme.

Keto elemente do të kenë për qëllim të stimulojnë lojën në mënyrë kreative.


Është një hapësirë e aksesueshme për të gjithë.

Pjesa e aksesueshme do të jetë me rreze dhe në vende të përcaktuara do të ketë gjelbërime , disa pemë të mëdha si palma etj.



Muzeu i Pavaresise


Kjo hapësirë do të vendoset për qark Muzeut aktual të Pavaresisë me qëllim riinterpretimin e historisë duke rikujtuar një kohë kur vetë deti ishte shumë afër kësaj ndërtese, integrimi i elementeve të muzeut.




Hapesirat rrethuese te Muzeut do te jene te shtruara me rere dhe gjelberimi rrethues do te jete i perbere prej palmave tropikale. Eshte e rendesishme qe palmat te cilat jane ekzistuese te rimbillen ne kete hapesire, ne rastet qe jane te shendetshme.

E gjithë hapesira do te jete e aksesueshme dhe per njerezit me aftese te kufizuara eshte parashikuar nje hapesire kalimi e cila do te jete e shtruar me beton te pigmentuar me ngjyre.

Perreth kesaj hapesire si kufizues i ketij rrethi do te jete nje bordure e cila do te jete e ngritur mjaftueshem per te qene dhe stol dhe hapesire pushimi.








Kjo hapësirë është menduar posaçërisht për të sjellë sa më pranë peizazhin ekzistues jugor. Me një topografi të adaptuar ky rreth i vecantë do të jetë i mbjellë me një bimë karakteristike lokale siç është pema e ullirit, por të specieve të ndryshme të kësaj familjeje bimesh.

Do të jetë e aksesueshme për të gjithë, pavarësisht terrenit të vështirë.

Hapësira ndërmjetese midis pemëve të ullinjve do të jetë e mbjellë me bar.





Mali




Ky rreth eshte nje element topografik i cil merr pamjen e nje kodre te gjelberuar e cila ka per qellim te krijoj nje pike te larte shikimi , prej te ciles mund te shihet i gjithe parku , deti dhe muzeu i pavaresise.

Do te jete i aksesueshem per te gjithë dhe neper te gjithë siperfaqen e tij do te kete peme te mbjella te cilat do te rrethohen nga nje siperfaqe e gjelberuar.

Aksesimi i majes se kesaj kodre apo mali do te jete i mundur me ane te nje shkallareje prej betoni .




Rrethi i ujit



Pertej te qenurit nje siperfaqe e cila eshte vizualisht ftuese qellimi i kesaj hapesire eshte te jete edhe nje hapesire loje ku vizitoret te mund te kalojne nga nje dhome uji ne tjetren .Uji i shatervaneve vjen duke u ngritur dhe duke u ulur gje qe ben te mundur kalimin e ketyre dhomave pa u lagur prej tyre .Ne momentin qe shatervanet jane te mbyllur ne kete hapesire mund te organizohen evente te ndryshme.

Kjo hapesire nuk do te kete gjelberim.





FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

ANALIZA HISTORIKE

KONTRATA N°: SH/Shërbime/2019/GoA/SH-20

Qershor 2020

XDGA + iRI

Konteksti Historik I Qytetit te Vlores

Vlora është një nga qytetet më të vjetra dhe qyteti i dytë port më i madh në Shqipëri. Rëndësia e saj historike shtrihet edhe në faktin se në Vlorë u shpall Deklarata e Pavarësisë Shqiptare dhe më parë ka qenë kryeqyteti i Shqipërisë. Gjatë pushtimit italian në 1914 vetë qyteti u fut në brendësi dhe zona e portit ishte rreth 2 km në jug nga qyteti. Ishte në këtë periudhë që u ndërtua skela e portit dhe një Bulevard 2 km që lidh qytetin me portin e "Skelës", Bulevardin aktual historik të Vlorës. Me ndërtimin e portit dhe të rrugës bregdetare, dhe falë pozicionit gjeografik të varfër në rrugët ndërkufitare evropiane, të vendosura në gjirin e gjerë kur Adriatiku takohet me detin Jon, Vlora u bë një nga qytetet më të rëndësishme ekonomike dhe turistike në Shqipëri. Pas viteve '90 niveli i urbanizimit të qytetit pothuajse u dyfishua duke u rritur drejt detit dhe duke ndryshuar komplet marrëdhëniet e qytetit me detin.

Sistemi urbanistik i qytetit ka dy elementë urbanistikë që e bëjnë qytetin të veçantë: dy akset e dominuese rrugore paralele, që e përshkojnë qytetin në drejtimin veri-jug, Bulevardi Vlorë-Skelë dhe Rruga Transballkanike; prezenca e shesheve urbane, si në pjesën e vjetër të qytetit ashtu edhe në qytetin e ri, Sheshi "4 Heronjtë", Sheshi i "Flamurit", Sheshi "Pavarësia" si dhe sheshe më të vegjël, që krijohen natyrshëm nga intersektimi i rrugëve dhe hapësirat ndërmjet ndërtesave.



Vlora në lashtësi quhej Aulona. Ajo përmendet nga shumë udhëtarë dhe kronikanë të huaj, si një nga qytetet – skelë kryesore të Ilirisë së Jugut, që lulëzoi pas rënies së Apollonisë dhe

Orikut.

Emri i Vlorës është ndër të paktët emra gjeografike të bregdetit lindor të Adriatikut që i ka qëndruar kohës qysh nga lashtësia. Në bregdetin e banuar sot nga popullsia shqiptare, ky emër gjeografik del i një lashtësie pak a shumë të përafërt me ato të Durrësit, Shkodrës, Lezhës dhe Ulqinit. Këta emra gjeografik nuk do t'i kishin rezistuar kohës në rast se vendbanimet e emërtuara prej tyre nuk do të kishin pasur një vazhdimësi përdorimi në radhë të shekujve... Një pjesë e mirë e popullsisë së trevave të banuara nga stërgjyshërit e shqiptarëve mundi t'i rezistonte procesit të romanizimit dhe më pas të sllavizimit, që përfshiu pjesën më të madhe të Gadishullit Ballkanik", nënvizon në studimet e veta akademiku Prof. Shaban Demiraj.

Sipas materialeve arkeologjike, dëshmohet se në bregdetin e Vlorës, ashtu edhe në prapavijën e tij, për vendbanime parahistorike e zhvillime ekonomike-kulturore të shumë qytezave e qendrave urbane dallohej karakteri i tyre fortifikues-mbrojtës.

Të tilla janë ato të "Shpellave të Velçës", "Shpellave të shkruara të Lepenicës" (nga më të rrallat në Ballkan e Mesdhe), "Shpellat e Spilesë" (Himarë) apo "Mozaikët e Mesaplikut", pasuri e rrallë kombëtare. Vendbanimet tumulare të Vajzës, Dukatit, Mavrovës, "Pitosa" të Mallkeqit tregojnë për autoktoninë dhe vazhdimësinë etno-kulturore të ilirëve në periudhën e bronzit dhe të hekurit.

E njëjta gjë dëshmohet edhe në vendbanimet e tjera të lashtësisë që janë qytete-kala si Amantia, Olympia, Kanina, Himara, Cerja, Armeni, Hadëraj, Triporti dhe vet Vlora (Aulona) etj.

Amantia, e themeluar në shek. V p.e.s., është një nga qytetet e pakta të Ilirisë jugore që ka pasur jetë 1000 vjeçare, ku spikat më shumë ndërtimi në terren malor i stadiumit antik madhështor, i ndërtuar me blloqe të mëdhenj gurësh.

Në jug të qytetit të Vlorës gjendet qyteti i Orikumit, i cili ka qenë një nga portet më të lashte të bregdetit të Vlorës, i themeluar si vendbanim në shek. VI-V p.e.s.

Oriku u bë port i fortifikuar, bazë e rëndësishme ushtarake në Adriatik dhe në shek. II-I p.e.s. ishte kantier i rëndësishëm detar për ndërtim e riparim anijesh, gjë që favorizohej nga prania e madhe e pyllit me pisha të Llogarase dhe Sera e Selenicës. Në shek. I p.e.s. Oriku shërbeu si kryeurë e fuqive pushtuese të kohës, arenë luftime midis Romës, Maqedonisë dhe Ilirisë, si dhe në luftën rivale midis Çezarit e Pompeut që i solli Orikut shumë shkatërrime. Në shek. II p.e.s., Oriku u godit nga një tërmet i fuqishëm dhe u shkatërrua duke e humbur rëndësinë e tij, pa mundur të rimbëkëmbej më. Ishte pikërisht koha kur në gjirin e Vlorës del në pah një tjetër qytet-Skelë, që ishte "Aulona – Vlora e sotme". Dëshmi arkeologjike e lashtësisë dhe autoktonisë është edhe vetë simboli i saj – "Vajza aulonase", një skulpturë "hyjneshe" 87 cm., e gdhendur nga mjeshtër vendas me gurin gëlqeror të Kaninës, që simbolizon veshjen e grave ilire.

Emrin e qytetit – Skelë të Aulonës së lashtë e gjejmë të përmëndur në shek. II e.s., nga shkrimtari Lukani dhe nga gjeografi Aleksandrin Ptolemeu. Këto të dhëna burimore përputhen me të dhënat e tjera të përafërta, siç janë dëshmitë arkeologjike për një kështjellë, port e

bankinë të madhe (kështjella e Jangjeçit, Triport), që kanë ekzistuar ndoshta kur lumi Vjosa e kish grykëderdhjen aty në Lagunën e Nartës. Por, ndoshta kur Vjosa u largua në drejtimin verior, Triporti humbi mundësinë dhe rëndësinë. Pikërisht në këtë kohë duhet të ketë origjinën Aulona port i spostuar në JL, e cila del si skelë – qëndër tregëtare – dhe Kanina – qëndër administrative – ushtarake në shek. VI e.s. Fakti që në shek.V-VI e.s., ka pasur në Vlorë edhe një peshkop, varur nga metropoliti i Durrësit, tregon se Aulona ka qenë vendbanim me rëndësi. Këtë e mbështet edhe zbulimi i viteve të fundit i traktatit të murit rrethues mbrojtës, fortifikues në qëndër të qytetit të sotëm të Vlorës (pranë monumentit të Pavarësisë) si dhe zbulimi i disa dëshmimeve të reja për ekzistencën e molit të vjetër, në afërsi të stacionit të trenit.

Gërmimet e fundit në Kaninë dhe Himarë kanë dhënë dëshmitë e tjera për kulturën ilire të antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme, për autoktoninë dhe vazhdimësinë iliro-arbërore dhe mesjetare shqiptare. Në shek. VI e.s., dhe vazhdimisht gjatë mesjetës, Aulona përmendet në listën e qyteteve bregdetare si port i rëndësishëm, me detari të zhvilluar, që tregëton vaj ulliri, kripë, valanidh, lëndë drusore, ullinj si dhe panairët që bëheshin në afërsitë e Vlorës, ashtu edhe në vende të ndryshme të Europës. Edhe në grykën e Vjosës ishte skela e Spinaricës, ku zhvillohej tregti dhe aty ishin të pranishëm edhe konsuj tregtarë të Raguzës, Venedikut etj. Në mesjetë Vlora dhe viset e saj ranë nën pushtimin normand më 1081, më pas nën pushtimin e Venedikut më 1205 dhe atë të sundimit të Hohenstaufenëve gjerman, siç e përshkuan edhe Jireçeku në studimin e tij.

Si një qëndër e zhvilluar dhe e kulturuar Vlora shfaqet edhe në mbretërinë e Arbërisë më 1272, ku kronikat e kohës shënojnë lulëzimin e zejtarisë, tregëtisë, blegtorisë dhe pemtarisë, të përfshirë si despotat më vete.

Një rol të madh në jetën politike, ushtarake e shoqërore të Vlorës, ka lozur edhe familja e madhe Arianitët, të cilët përmenden në shek.XI, nëpërmjet të parit të tyre Arianit Komnen Golemi Topisë, sidomos në shek. XV-XVI. Një nga figurat e shquara të shek.XV është Gjergj Arianiti, i cili organizoi qëndresën kundër pushtuesve osman më 1431-1432 e më pas në grykat e Labërisë. Me bëmat e tij, Gjergj Arianiti mori përgëzimet e Fuqive të Mëdha të Europës të asaj kohe. Edhe pse ishte aleat me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun dhe vjehrrin e tij, pasi Donika, e bija e tij u martua me Skënderbeun, Gjergj Arianiti ishte i pavarur në zoterimet e tij në jug dhe në Shqipërinë e Mesme. Në Kuvendin e Lezhës, më 2 Mars 1444, për t'i bërë ballë rrezikut të pushtimit osman, Gjergj Arianiti u rradhiti ndër të parët krerë sundimtarë shqiptarë, në këtë lidhje ushtarake mbarëkombëtare. Në shek.XV-XVI pushtuesit osman e kthyen portin e Vlorës në një nyje të rëndësishme të Adriatikut për pushtimin e Italisë.

Në regjistrin turk të vitit 1520 shënohen 701 familje vendase dhe 531 familje çifute. Kjo dëshmon për një klimë paqësore e tolerancë ndaj çifutëve në qytet në një kohë kur gjetke ata persekutoheshin egërsisht. Kështu qyteti përmbledhëte 6300-6500 banorë. Nga Vlora u nisën fuqitë ushtarake osmane kundër Italisë së Jugut, më 1480, kundër kryengritjes së himarjotëve më 1492 dhe shërbeu si bazë e sulltan Sulejmanit kundër Korfuzit, më 1537. Po në këtë vit u ndërtua kështjella e qytetit (aty ku sot ndodhet stadiumi “Flamurtari”), gurët e së cilës u morën nga kështjella e Jangjeçit në Zvërnec dhe nga muri rrethues i Aulonës.

Në shek.XVII-XVIII Vlora ishte një nga limanet më të rëndësishëm të Shqipërisë së Jugut, pas Prevezës, pasi gjiri i saj u siguronte anijeve mbrojtje nga stuhitë. Në skelën e Vlorës ishin ndërtuar depo të mëdha për grumbullimin e prodhimeve buqësore e blegtorale të fshatarësisë, ku përfshiheshin zona e Beratit, Gjirokastrës dhe Myzeqesë. Në eksportin e tij ky qytet zhvillonte tregti më Triesten, Venedikun, Vjenën, Korfuzin, Stambollin, Izmirin, Breshian, Barin, Manastirin, Janinën, Maltën e Qipron. Në portin e Vlorës hynte rregullisht çdo javë vaporit austriak “Lloid” dhe ai italian “Pulja”, të cilët vetëm për vitin 1904 kishin kryer respektivisht 224 dhe 181 hyrje-dalje. Vlora eksportonte: vaj ulliri – 20.000 fuçi, ullinj të vjelur – 11.000 barrë, kripë – 1.5 milion kilogram, lesh të palarë – 15.000 okë, lëkurë qengji e lepuri – 20.000 copë, breshka – 40.000 copë, shushunja, shpende, dele, kuaj, mish të therur, peshk të kripur, vezë peshku, serë, asfalt, misër, tërshërë, thekër, fasule, dru zjarri, valanidh, mjaltë të bardhë Kanine, verë të Nartës dhe verë “Vlosh” të Vlorës.

Një artikull i kërkuar ishte edhe stralli i gurores së Drashovicës, që përgatitej me blloqe dhe ashkla. Për eksport, gëzofet prej lëkure, velenxat dhe brucat labe ishin artikuj mjaft të preferuar për Istrien, Triesten dhe vendet alpine...Ulliri i markës “Vlonjak”, që ishte më i lashtë se marka italiane dhe frënge, dallohej për prodhueshmëri të lartë, vaji dhe regjie lëkure. Në vitin 1900 Vlora regjistronte mbi 100.000 rrënjë ullinj.

Vlora njihet si një vatër e rëndësishme e patriotizmit ndër shekuj, ku përpjekjet për liri, pavarësi dhe prosperitet kanë qenë në shpirtin e çdo vlonjati.

Luftat kundër pushtimeve të huaja dhe përpjekjet për përhapjen e arsimit shqip bënë që në Vlorë të krijoheshin shumë shoqëri patriotike.

